

Njoftim

Sot, më datë **24.05.2023**, ora **14:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Blerona Hasa (Relatore);**
- 2. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Esmeralda Xhili (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.22 Regj.Themeltar, Datë 16.05.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Gledian Llatja, përfaqësuar nga Mariolla Ndini.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Objekti: Ndryshimin e Vendimit nr.84, datë 08.05.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve “Për shqyrtimin e kërkesës nr.21, datë 06.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, për pjesën që ka të bëjë me vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, duke vendosur sanksionin sipas nenit 171, pika 2, të Kodit Zgjedhor nga 1 000 (një mijë) deri në 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë.

Baza ligjore: Kodi i Procedurës Administrative, neni 130 e vijues, si dhe Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, neni 145, pika 1.

me Vendimin Nr.22, datë 24.05.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesëpadisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
U shpall në Tiranë më datë 24.05.2023.

Tiranë, më 24.05.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë